



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:032286
Datë: 24.03.2025
Numri i dokumentit: 07035007

CA.nr.1698/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Halide Reka, kryetare e kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.D nga fshati B., Komuna e Lipjanit, të cilin me autorizim e përfaqëson Arif Hasi, avokat nga Drenasi, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale për Arsim, për kompensimin e shpenzimeve për ushqim, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.*/20, të datës 21.12.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 24.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale për Arsim, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, , Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.*/20, të datës 21.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.*/20, të datës 21.12.2023, ka vendosur si vijon:

I.APROVOHET kërkesëpapia e paditësit H.D nga fshati B. , si e BAZUAR, OBLIGOHET e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të ia paguaj shumën prej 880.00-€, në emër të kompensimit për ushqim për periodën 18.04.2017 e deri me datë 20.01.2019, me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 21.12.2023 e deri të pagesa definitive, si dhe në shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej 238.00-€, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dorëzimi i aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e të paditurës të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të priset dhe të refuzohet në tërësi kërkesëpapia e paditësit si e pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet, si dhe të detyrohet e paditura që në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë të paguaj 208 euro.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi H.D nga fshati B., Komuna e Lipjanit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me dt.03.03.2020 në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *‘Kur gjykata, pasi të arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë’*, andaj gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore ka nxjerrë aktgjykim pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që ka vlerësuar se në rastin konkret, kërkesëpapia e paditëses është e themeltë, pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shumën e shpenzimeve të ushqimit, vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj ka nxjerrë aktgjykimin, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marrë duke u bazuar në dispozitat e nenit 452 par.1 dhe 2 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi kamatën gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditësit dhe nuk ka bërë tejkalim të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara drejt është vërtetuar gjendja faktike se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU “N”, në Lipjan dhe në bazë të vërtetimit me nr. të prot.****, të dt.28.04.2022, lëshuar nga komisioni në përbërje nga drejtori, përfaqësues – mësimdhënës të shkollës dhe kryetari i sindikatës në nivel shkolle, vërtetoj faktin se paditësi H.D nga B.i, është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe gjatë periudhës nga data 18.04.2017 deri me 20.01.2019, i njëjti ka punuar 440 ditë pune. Duke u nisur nga fakti se e paditura paditësit nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të paraparë me dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata me të drejt ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit e detyroi të paditurën që për 440 ditë të pranisë në punë të ia paguaj shumën prej nga 2 euro për secilën ditë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 5 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”. Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “Të punësuarve, (anëtarë të SBASHKut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit

që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes të së drejtës për të parashtruar kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko-civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit- shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragrafin 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, meqenëse nënshkruerit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si të pambështetur kërkesën e të autorizuarit të paditësit për kompensim të shpenzimeve shtesë në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë, pasi kjo parashtrësë nuk ka qenë me ndikim në vendosjen sipas ankesës dhe në kuptim të nenit 453.1 të LPK-së, nuk pranohet si shpenzim i domosdoshëm për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2020:032286
Datë: 24.03.2025
Numri i dokumentit: 07035007

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.1698/24, me datë 24.03.2025

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka